

# HULUMTIM NË PROCESIN E DHËNIES SË LEJEVE TË INTEGRUARA EKOLOGJIKE B



## HULUMTIM NË PROCESIN E DHËNIES SË LEJEVE TË INTEGRUARA EKOLOGJIKE B

Botim elektronik:  
(HULUMTIM NË PROCESIN E DHËNIES SË LEJEVE TË INTEGRUARA EKOLOGJIKE B)

Titulli origjinal i botimit:  
ИСТРАЖУВАЊЕ ЗА ПРОЦЕСОТ НА ДОДЕЛУВАЊЕ Б-ИНТЕГРИРАНИ ЕКОЛОШКИ ДОЗВОЛИ

Botues:  
Qendra për Komunikime Qytetare

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:  
Agon Ismaili

Dizajn grafik:  
Relativ

Shkup, korrik 2024

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје  
352.077.3:502.17]:66/67(497.7)(047.31)

ЦЕНТАР за граѓански комуникации

Истражување за процесот на доделување б-интегрирани еколошки дозволи [Електронско издание] = Research on the process of issuing b-integrated environmental permits = Hulumtim në procesin e dhënies së lejeve të integruara ekologjike b / Центар за граѓански комуникации ; translation from macedonian to english Magdalena Simionska ; përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Agon Ismaili. - Текст во ПДФ формат, содрж. 20, 20, 20 стр., фотографии. - Скопје : Центар за граѓански комуникации ; Skopje : Center for Civil Communications ; Shkup: Qendra për Komunikime Qytetare, 2024

Начин на пристапување (URL): <https://ccc.org.mk/images/eko.pdf>. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 10.07.2024 год. - Напореден текст на мак., алб. и англ. Јазик

ISBN 978-608-4974-36-9

а) Б-интегрирани еколошки дозволи -- Издавање -- Индустриски капацитети  
-- Локална самоуправа -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 64058373



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrotje nga korrupsioni" me asistencë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, i zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 nëntor 2021 deri më 31 tetor të vitit 2024.

# PËRMBAJTJA

- 4 / GJETJET KRYESORE
- 6 / SYNIMI I HULUMTIMIT
- 8 / HULUMTIM NË PROCESIN E DHËNIES SË LEJEVE TË INTEGRUARA EKOLOGJIKE B
- 19 / REKOMANDIME




## GJETJET KRYESORE

- **Askush në vend nuk ka të dhëna të sakta për numrin e lejeve të integruara ekologjike B të cilat komunat ua lëshojnë kompanive, veprimtaria e të cilave ndikon mbi mjedisin jetësor.** Sipas regjistrit që e mban Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor (MMJPH), 278 kompani janë bartës të lejeve të integruara ekologjike B. Megjithatë, bazuar në këtë hulumtim, rezulton se një pjesë e lejeve të lëshuara nga komunat nuk janë të publikuara në Regjistrin, ndërsa disa nga kompanitë me leje të tilla, edhe pse i kanë mbyllur stabilimentet e tyre, ato ende figurojnë të regjistruara në Regjistër.
- **Askush nuk ka përgjigje për pyetjen se cilat janë ato kompani që duhet të kenë leje të integruar ekologjike B.** Vendi nuk ka një sistem të integruar dhe as mekanizëm kontrolli me të cilin do të përfshihen të gjitha kapacitetet industriale të cilat me aktivitetet e tyre emetojnë materie të dëmshme për mjedisin jetësor. Komunat nuk kanë regjistër të ndotësve. Disa nga komunat i kanë formuar të ashtuquajturat kadastra të ndotësve, mirëpo në nivel të industrive, por jo të firmave veçmas.
- **Edhe pse firmat që posedojnë leje të integruara ekologjike B duhet të paguajnë tarifa sipas disa bazave, megjithatë komunat e mëdha mbledhin vetëm nga disa mijëra denarë çdo vit në këto baza.** Kjo situatë hap dyshime se komunat nuk ua përlllogarisin të gjithë bartësve të licencave tarifat për bartje të licencës së integruar B. Në të njëjtën kohë, shihet se disa nga subjektet nuk i paguajnë rregullisht as tarifat aq të ulëta të cilat e kanë përgjegjësi t'i paguajnë.
- **Tarifat vjetore që i paguajnë kompanitë të cilat posedojnë licencë të integruar B dallojnë nga 915 denarë deri në 22,860 denarë.**
- **Dallimet e mëdha në të ardhurat që komunat i realizojnë mbi këtë bazë çojnë në konstatimin se nuk ka mënyrë të njëzuar të përlllogaritjes së tarifave për lejet e integruara ekologjike B.**
- **Duke e pasur parasysh se tarifat vjetore, çdo vit janë identike për shumicën e stabilimenteve që posedojnë leje të integruar ekologjike B, kjo mund të interpretohet në mënyrën se disa prej stabilimenteve nuk paraqesin as raporte vjetore për matjet e ndotjes dhe se tarifa vjetore e tyre nuk përcaktohet plotësisht.**

- Të gjitha të dhënat për të ardhurat e realizuara nga lejet e integruara B janë siguruar përmes Ligjit për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik. Komunitet nuk e kanë praktikë për t'i informuar qytetarët për të ardhurat që i realizojnë nga kompanitë që janë bartës të lejeve të integruara B. Mungesa e transparencës e rrit rrezikun për abuzime.
- Lartësia e tarifave vjetore të cilën e paguajnë kompanitë që kanë licencë të integruar B dallon prej 915 deri në 22,860 denarë.
- Çdo e dyta komunë ballafaqohet me mungesë të personelit inspektues në sferën e mjedisit jetësor.
- Dobësitë e identifikuara në dhënien e lejeve të integruara ekologjike B i zmadhojnë rreziqet për abuzime dhe korrupsion në sferën e mjedisit jetësor.





## OBJEKTIVI I HULUMTIMIT

Objektivi i këtij hulumtimi është të hartëzohen praktikat aktuale në lidhje me dhënien e lejeve të integruara ekologjike B, kryesisht për shkak të problemeve të zmadhuara që janë detektuar në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor në shtetin tonë. Në Strategjinë Nacionale për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (2021-2025) thuhet se ky sektor viteve të fundit fiton në relevancë për shkak të instalimit të lejeve të ndryshme ekologjike si dhe lejeve të tjera të cilat subjektet afariste duhet t'i kenë për t'i filluar/kryer aktivitetet e tyre operationale. Hulumtimi është nxitur nga rreziku nga korrupsioni gjatë këtij procesi, i cili e imponon domosdoshmërinë për një analizë mbi praktikat ekzistuese, zbulim të problemeve dhe përpilim të rekomandimeve të përshtatura me qëllim të rritjes së transparencës dhe integritetit në këto procedura.

Me Ligjin për Mjedisin Jetësor është rregulluar mënyra e mbrojtjes, restaurimit dhe avancimit të cilësisë së mjedisit jetësor, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, që nënkupton të parashikohen, monitorohen, kufizohen dhe të mënjanoohen ndikimet negative mbi mjedisin jetësor. Me qëllim të reduktimit të ndotjes si dhe lartësimin e standardeve për cilësinë e mjedisit jetësor, nëpërmjet realizimit të zhvillimit ekonomik pa degradim të mjedisit jetësor, në përputhje me ligjin, janë instaluar lejet e integruara ekologjike për ndotësit. Varësisht nga lloji dhe vëllimi i aktiviteteve, që përcaktohen sipas një pragu konkret për një kapacitet të instaluar prodhimi apo sipas llojit të lëndës së parë që përdoret në procesin e prodhimit, stabilimentet duhet të posedojnë leje të integruara ekologjike A, të cilat i lëshon Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor ose leje të integruara ekologjike B të cilat i lëshojnë komunat.

Qeveria e RMV-së i përcakton satbilimentet për të cilat kërkohet leje e integruar ekologjike A dhe/ose leje e integruar B sipas Dekretligjit për përcaktimin e aktiviteteve të stabilimenteve për të cilat lëshohet leje e integruar ekologjike, përkatësisht leje për harmonizim me planin operacional dhe agjendë kalendarike për parashtrimin e kërkesave për leje për harmonizim me planin operativ. Termi "Stabiliment", në kontekstin e lejeve të integruara ekologjike, nënkupton një njësi teknike stacionare, një kapacitet industrial, në të cilin kryhen aktivitete, ndërsa të cilat mund të kenë efekt në emetimet dhe ndotjen.

Operatorët e stabilimente të reja me emetime të dëmshme për mjedisin jetësor si dhe për jetën dhe shëndetin e njerëzve, në rastet kur bëhet fjalë për stabilimente me kapacitet më të vogël, janë të detyruar të sigurojnë leje të integruar ekologjike B. Në kontekstin e parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes, leja paraqet një vendim me shkrim, me të cilin jepet autorizim për funksionimin e një stabilimenti që u nënshtrohet kushteve të caktuara me të cilat sigurohet që ai stabiliment është në përputhje me kërkesat ligjore.

Me qëllimin për të hartëzuar situatën me dhënien e lejeve të integruara B, Qendra për Komunikime Qytetare, së bashku me organizatat joqeveritare të përfshira në zbatimin e projektit "Mbrotjtje nga korrupsioni" (Qendra Kulturore Rinore - Manastir, Koalicioni Rural, Qendra për Dialog Ndërkulturor, Shoqëria Ekologjike "Vila Zora" Veles, Shoqata e Qytetarëve - Qendra për Hulumtime dhe Analiza - NOVUS Strumica, Shoqata Multikultura, Shoqata e Qytetarëve - ZIP Instituti për Politika dhe Qeverisje të drejtë dhe EHO Organizata Edukative-Humanitare), kanë dërguar kërkesa identike për informacione në tetë komunat që janë përfshirë me këtë projekt. Nga komunat Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Tetovë, Strumicë, Çair dhe Shtip janë kërkuar informacionet si vijon: sa kapacitete/stabilimente industriale funksionojnë në territorin e komunës së tyre; a kanë të themeluar ndonjë Regjistër të ndotësve; sa leje ekologjike të integruara B kanë lëshuar si komunë në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022; a ka lëshuar Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor leje të integruara ekologjike B për operatorët në emër të komunës; sa njerëz në komunë kryejnë punën për dhënien e lejeve të integruara ekologjike B, ndërkaq cili është numri i paraparë i vendeve të punës për këtë fushë në aktin për sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës në komunën konkrete; a është përpiluar/miratur Rregullore për përcaktimin e kushteve për dhënie të lejes të integruar ekologjike B; cila është shuma e të ardhurave të realizuara në periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2022 në të gjitha bazat që kanë të bëjnë me lejet e integruara ekologjike B për çdo stabiliment veçmas; cili është numri i vendeve të parapara me sistematizimin dhe numri i vendeve të punës që janë të plotësuara – për inspektor të licencuar për mjedis jetësor në komunë; nëse në komunë nuk ka të punësuar asnjë inspektor të licencuar për mjedis jetësor, kush i kryen aktivitetet në domenin e mbikëqyrjes inspektuese; në periudhën nga 2018 deri 2022, a është ushtruar mbikëqyrje në punën e inspektorëve të licencuar nga ana e ndonjë inspektori shtetëror; sa inspektime të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese janë planifikuar dhe sa janë zbatuar në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022; sa leje të integruara B janë hequr në periudhën 2018-2022 për shkak të shkeljes së kushteve detyrimore të përcaktuara me lejen; të dërgohen programet vjetore dhe raporte të punës për zbatim të mbikëqyrjes inspektuese në periudhën 2018-2022; në çfarë mënyre monitorohen gjendjet e stabilimentet që emetojnë substanca të rrezikshme dhe të cilat kanë leje të integruara ekologjike B; a keni të dhëna për mënyrën se si operatorët e stabilimenteve i monitorojnë emetimet që burojnë nga aktivitetet e tyre, e të cilat ndikojnë mbi mjedisin jetësor dhe nëse operatorët janë të detyruar që këto të dhëna t'i dorëzojnë në komunë si dhe në çfarë mënyrë janë përdorur paratë e arkëtuara në bazën për tarifatat për leje të lëshuara ekologjike të integruara-B.

Hulumtimi është përgatitur në bazë të informatave të cilat komunat i kanë dërguar.



## HULUMTIM PËR PROCESIN E LËSHIMIT TË LEJEVE TË INTEGRUARA EKOLOGJIKE B



- Askush në vend nuk ka të dhëna të sakta për numrin e lejeve të integruara ekologjike B të cilat komunat ua lëshojnë kompanive, ndërsa veprimtaria e të cilave ndikon mbi mjedisin jetësor. Sipas Regjistrit, të cilin e mban Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, 278 kompani janë bartës të lejeve të integruara ekologjike B. Megjithatë, nga hulumtimi ka rezultuar se një pjesë e lejeve të lëshuara nga komunat nuk janë të publikuara në Regjistër, ndërsa disa nga kompanitë me leje të tilla, edhe pse i kanë mbyllur stabilimentet e tyre, ende figurojnë të regjistruara në regjistër.

Komunat i lëshojnë lejet e integruara ekologjike B. Në rast kur stabilimenti gjendet në ndonjë zonë të përcaktuar si zonë e mbrojtur në përputhje me ligjin, autoriteti kompetent për dhënien e lejes së integruar ekologjike B është Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor. Kryetari i komunës e ka për detyrë të mbajë regjistër komunal për lejet e integruara ekologjike B për territorin e komunës së tij, si dhe të dërgojë një kopje të atij regjistri në MMJPH, ku menaxhohet dhe mbahet Regjistër i Vetëm i lejeve të lëshuara të integruara ekologjike B.

[Regjistri i Vetëm i lejeve të lëshuara të integruara ekologjike B](#) është publikuar në ueb-faqen e Ministrisë, por në të nuk janë të evidentuara të gjitha lejet e lëshuara të integruara ekologjike B.



Nga hulumtimi rezulton se në Regjistrin e Vetëm të lejeve të lëshuara të integruara ekologjike B, të cilin e menaxhon Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, nga njëra anë mungojnë kompanitë të cilave u janë dhënë leje të integruara B dhe në anën tjetër, kompanitë të cilat nuk janë më bartës të lejeve të integruara B ende figurojnë në Regjistrin e Vetëm. Kështu, në Regjistrin e Vetëm nuk mund të gjenden 5 kompani për të cilat Komuna e Negotinës në periudhën e kaluar ka lëshuar leje të integruara B, ndërkaq në Regjistrin figuron emri i një kompanie nga Kumanova, të cilës i ka skaduar leja, ndërsa stabilimenti për të cilin është lëshuar ajo leje tashmë është mbyllur.

Më konkretisht, sipas të dhënave nga hulumtimi, në Regjistrin e Vetëm të lejeve të lëshuara të integruara ekologjike B mungojnë kompanitë "Junior-trejd" SHPKPV dhe SHPTSH "VS-GD" SHPKPV Kavadarci, e për të cilat lejet e integruara B janë lëshuar në vitin 2015, pastaj SHPTSH "Vardar Pesok" SHPK me leje të lëshuar në vitin 2017, SHPTSH "Internacional Fresh Food" SHPK me leje nga viti 2021 dhe Shoqëria ndërtimore "Granit" me leje nga viti 2023. Komuna e Negotinës ka lëshuar leje të integruara ekologjike B për këto kompani, por ato nuk janë në Regjistrin e Vetëm të menaxhuar nga MMJPH-ja. Nga ana tjetër, në Regjistrin e Vetëm nuk është evidentuar që ka pasur ndryshime në disa prej stabilimenteve lidhur me bartjen e lejeve të integruara ekologjike B (p. sh. Qumështorja "Zdravje Radovo" SHPK). Në përgjigjen nga Komuna e Kumanovës, thuhet se leja për stabilimentin e qumështores ka skaduar dhe stabilimenti është mbyllur, mirëpo këto të dhëna nuk janë azhurnuar në Regjistër. Sipas kësaj, nuk është e mundur të vërtetohet numri i stabilimenteve në vend, të cilat kanë leje të integruara ekologjike B, për shkakun se në Regjistër, disa stabilimente mungojnë, ndërsa disa të tjera nuk janë fshirë.

Në bazë të Ligjit për Mjedisin Jetësor, kryetarët e komunave e kanë për detyrë të mbajnë regjistër komunal, përkatësisht të qytetit (për Qytetin e Shkupit), për lejet e integruara ekologjike B për zonën e tyre, si dhe një kopje t'ia dërgojnë organit të administratës shtetërore i cili është kompetent për çështjet nga sfera e mjedisit jetësor (MMJPH).

Vështruar përmes perspektivës së komunave, hulumtimi i zbatuar tregoi se komunat që kanë lëshuar leje të integruara ekologjike B, në përputhshmëri me këtë, ato mbajnë regjistra komunalë për to. Megjithatë, është vërejtur një mospërputhje mes të dhënave në regjistrat komunalë dhe të dhënat e Regjistrit të Vetëm për lejet e lëshuara të integruara ekologjike B të cilin e mban Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor.

### Regjistrat komunalë të lejeve të integruara ekologjike B

Komuna	Komuna mban regjistër të lejeve të integruara-B
Manastir	po
Kërçovë	po
Kumanovë	po
Negotinë	po
Strumicë	po
Tetovë	Nuk ka lëshuar leje të integruara-B dhe prandaj nuk ka regjistër
Çair	Nuk ka lëshuar leje të integruara-B dhe prandaj nuk ka regjistër
Shtip	po

Përndryshe, krahas Regjistrit të Vetëm të lejeve të lëshuara të integruara ekologjike B që është në ueb faqen e Ministrisë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, Ministria ka zhvilluar edhe një ueb platformë të titulluar [www.registers.mk](http://www.registers.mk) të dedikuar për lejet ekologjike A dhe B. Nga hulumtimi është mësuar se në këtë platformë gjithashtu ka dobësi, për shkakun se, ajo për herë të fundit është përditësuar në vitin 2022 dhe në të mungojnë të gjitha lejet që janë lëshuar pas vitit 2022. Evidentimi i tillë i dyfishtë i bartësve të lejeve të integruara në mënyrë plotësuese mund të shkaktojë konfuzion te qytetarët, të cilët kanë interes për të kontrolluar nëse ndonjë kompani ka leje të këtij lloji.

- Askush nuk ka përgjigje për pyetjen se cilat janë kompanitë që duhet të kenë leje të integruar ekologjike B. Vendi nuk ka një sistem të integruar dhe as mekanizëm kontrolli me të cilin do të përfshihen të gjitha kapacitetet industriale të cilat me aktivitetet e tyre emetojnë materie të dëmshme për mjedisin jetësor. Komunat nuk kanë regjistër të ndotësve.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, në shtet ekzistojnë gjithsej 73,061 subjekte aktive afariste. Ndonëse dihet numri i saktë i subjekteve aktive afariste dhe si ato janë të ndarë nëpër sektorë në bazë të Klasifikimit nacional të veprimtarive, nuk dihet numri i saktë i kompanive që kryejnë aktivitete, kurse të cilat duhet të kenë leje të integruar ekologjike B. Një e katërta apo 18,965 nga këto kompani gjenden në territorin e komunave Manastir, Negotinë, Kërçovë, Kumanovë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip, komuna të cilat janë subjekt i hulumtimit tonë.

Në këto tetë komuna, sipas të dhënave që kemi marrë përmes kërkesave për qasje të lirë tek informacionet, janë lëshuar 56 leje të integruara ekologjike B. Shumica, përkatësisht 14 prej tyre në komunën Shtip, një më pak, përkatësisht 13 në Komunën e Strumicës, 11 në Komunën e Kumanovës, 7 në Komunën e Manastirit. Komuna e Negotinës ka lëshuar 5 leje të integruara ekologjike B. Për zonën e Komunës së Tetovës janë lëshuar 3 leje të integruara B, mirëpo ato janë lëshuar nga Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor për shkak se ndodhen në zonë të mbrojtur. Komuna e Kërçovës ka lëshuar dy leje. Numri më i vogël i lejeve edhe atë vetëm një, është lëshuar në Komunën e Çairit, në të cilën komunë, nga ana e Qytetit të Shkupit leja ekologjike e integruar-B i është lëshuar Shoqërisë për furnizim me avull dhe ujë të ngrohtë Shkup Veri SHA Shkup.

Numri i lejeve të lëshuara të integruara B në raport me numrin e kapaciteteve industriale të komunave tregon se tek të gjitha komunat pjesëmarrja është më pak se 1%. Përkatësisht, në komunën e Shtipit ka pjesëmarrje prej 0.76%, ndërsa në komunën e Çairit vetëm 0.05%.

## Leje të lëshuara të integruara ekologjike B

Komuna	Numri i përgjithshëm i lejeve të lëshuara të integruara B	Numri i kapaciteteve industriale	Lejet e lëshuara në raport me numrin e kapaciteteve industriale
Shtip	14	1,854	0.76%
Strumicë	13	2,394	0.54%
Kumanovë	11	3,019	0.36%
Manastir	7	3,829	0.18%
Negotinë	5	765	0.65%
Tetovë	3	3,707	0.08%
Kërçovë	2	1,462	0.14%
Çair	1	1,935	0.05%

Në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022, tetë komunat kanë lëshuar 23 leje të integruara ekologjike B. Numrin më të madh prej tyre, edhe atë nëntë gjithsej ka lëshuar Komuna e Kumanovës, pas saj është Komuna e Shtipit me shtatë leje të lëshuara, pastaj Komuna e Manastirit me tre leje të lëshuara, Strumica me dy leje dhe komuna e Kërçovës dhe Negotinës me nga një leje.

## Numri i lejeve të integruara ekologjike B të lëshuara nga komunat dhe MMJPH-ja

Komuna	Numri i lejeve të integruara ekologjike B që janë lëshuar gjatë periudhës 2018-2022	Numri i lejeve të lëshuara nga Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor
Kumanovë	9	0
Shtip	7	0
Manastir	3	0
Strumicë	2	0
Kërçovë	1	0
Negotinë	1	0
Tetovë	0	3
Çair	Lejet e integruara ekologjike B lëshon Qyteti i Shkupit	0

Gjatë kësaj periudhe, tetë bashkitë për herë të dytë kanë lëshuar gjithsej 10 leje të integruara ekologjike B. Kryetari i komunës e ka për detyrë që në çdo shtatë vjet t'i kontrollojë kushtet e përcaktuara me lejen dhe nëse janë bërë ndryshime në dispozitat për mbrojtje të mjedisit jetësor të cilat mund të ndikojnë në funksionimin e stabilimentit, ai e ka për detyrë të iniciojë procedurë për ndryshim të lejes së integruar-B. Asnjëra nga tetë komunat, në periudhën 2018-2022, nuk i ka hequr licencën për leje të integruar-B asnjërit prej stabilimenteve që janë bartës të lejeve.

### Numri i lejeve të integruara ekologjike B që janë lëshuar sërish

Komuna	Lejet e integruara B të rilëshuara
Kumanovë	5
Strumicë	3
Manastir	1
Negotinë	1
Kërçovë	0
Tetovë	0
Çair	Lejet e integruara ekologjike B për herë të dytë i lëshon Qyteti i Shkupit
Shtip	0

Për dhënie të lejes së integruar ekologjike B, komunat duhet të kenë të përcaktuar të paktën një person në administratën e vetëqeverisjes lokale, person i cili do të jetë me përgatitje të lartë profesionale në fushën e shkencave natyrore dhe teknike.

### Personat që punojnë në dhënien e lejeve të integruara B

Komuna	Numri i personave që punojnë në lëshimin e lejeve	Numri i përgjithshëm i lejeve të lëshuara të integruara B
Shtip	2	14
Strumicë	2	13
Manastir	2	7
Kumanovë	1	11
Negotinë	1	4
Kërçovë	1	2
Tetovë	0	3
Çair	0	1

Sic mund të shihet nga tabela, gjashtë nga tetë komunat kanë përcaktuar persona që punojnë në dhënien e këtyre lejeve. Komuna e Tetovës dhe Çairit nuk kanë lëshuar leje të këtij lloji, prandaj nuk kanë paraparë persona që do të merren me këtë çështje. Në komunën e Negotinës dhe komunën e Kërçovës, sipas sistematizimit, parashihet të punojnë një numër më i madh i njerëzve (shtatë dhe dy), por punon vetëm një person, ndërsa në komunën e Manastirit, sipas sistematizimit është paraparë një person, ndërsa në këtë pozicion janë të punësuar dy persona.

- Komunat nuk kanë regjistra të ndotësve. Disa prej tyre i kanë përpunuar të ashtuquajturat kadastra të ndotësve, megjithatë në nivel të industrive dhe jo të firmave individuale.

Sipas Rregullores për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për shkarkim dhe transmetim të ndotësve, këto regjistra duhet të përmbajnë të dhëna për stabilimentin me të gjitha kapacitetet në të si dhe për vendndodhjen gjeografike të stabilimentit, shkarkimin e ndotësve në mediumet e mjedisit jetësor (ajri, uji dhe toka), krijimin dhe transferimin e hedhurinave jashtë nga lokacioni si dhe destinacionin e tyre, etj. Asnjë nga komunat nuk ka mban regjistra të tillë.

Gjatë kësaj, nga gjithsej tetë komunat e përfshira në projekt, vetëm komunat Manastir, Kërçovë dhe Kumanovë i kanë themeluar të ashtuquajturat regjistra të ndotësve, e të cilat janë në nivel të industrive dhe në to nuk janë evidentuar stabilimentet veçmas ose ndotja të cilën ato stabilimente emetojnë. Komuna e Shtipit dhe komuna e Tetovës kanë informuar se janë të përfshira në një projekt të Ministrisë për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor për përgatitjen e kadastrave të ndotësve.

Duke qenë se nuk kanë përgatitur regjistra të ndotësve, nuk mund të pritët që komunat të kenë informata se sa kompani duhet të kenë leje të integruar ekologjike B, përkatësisht nëse të gjitha kompanitë që duhet të kenë parashtruar kërkesë për leje kanë vepruar në këtë mënyrë.

- Edhe pse kompanitë që janë bartës të lejes së integruar ekologjike B duhet të paguajnë tarifa në disa baza, megjithatë edhe komunat e mëdha mbledhin vetëm nga disa mijëra denarë në nivel vjetor mbi këtë bazë. Kjo situatë hap dyshim se komunat nuk ua përlllogarisin të gjithë bartësve të licencave tarifat për pasje të licencës së integruar B. Në të njëjtën kohë, e dukshme është se disa nga kompanitë nuk i paguajnë në mënyrë të rregullt as këto tarifa të ulëta të cilat e kanë për detyrë t'i paguajnë.

Në pajtim me Ligjin për Mjedisin Jetësor, stabilimentet që posedojnë leje të integruar B e kanë për detyrë që komunës t'i paguajnë tarifa në disa baza: parashtrim të kërkesës, modifikim i lejes, transferim i lejes, tarifë vjetore për leje, tarifë vjetore për mbikëqyrje të rregullt dhe tarifë për mbyllje të stabilimentit. Përcaktimi i vlerës së tarifave bëhet në bazë të numrit të vendeve tek stabilimenti nga të cilat shkarkohen emetime në mjedisin jetësor, numrin e kushteve dhe masave të detyrueshme të përcaktuara në lejen, llojin dhe madhësinë e emetimeve në mjedisin jetësor, si dhe në bazë të sipërfaqes që e zë stabilimenti. Më saktësisht, vlera e tarifave rregullohet me Dekretligjin për vlerën e tarifës që duhet ta paguajnë operatorët e stabilimenteve që kryejnë veprimtari për leje të integruar ekologjike B.

Sipas të dhënave që janë dërguar, vështuar në nivel të stabilimenteve, mund të shihet se tarifat vjetore që i paguajnë kompanitë të cilat posedojnë licencë të integruar B dallojnë nga një shumë prej vetëm 915 denarë deri në 22,860 denarë.

Ndërkaq, në nivel komunash, nga hulumtimi del në pah se të ardhurat që gjenerohen në këto baza janë konsiderueshëm modeste. Në periudhën pesëvjeçare 2018-2022, komunat e analizuar, mesatarisht kanë gjeneruar të ardhura duke filluar vetëm nga 1,220 denarë deri në 165,017 denarë në nivel vjetor.

Dallimet e mëdha në të ardhurat e realizuara lidhur me lejet e integruara B krijojnë dyshime se komunat nuk ua përlllogarisin të gjithë bartësve të lejeve tarifat për leje vjetore të integruar B.

Siç shihet nga prezantimi tabelor, komuna e Strumicës mbledh më së shumti të ardhura mesatarisht në vit, edhe atë 165,017 denarë (2,680 euro). Më pas është komuna e Kumanovës me të ardhura në shumë prej 146,204 denarë apo rreth 2,400 euro në nivel vjetor. Në vendin e tretë është komuna e Negotinës me të ardhura vjetore në këtë bazë me 35,000 denarë (570 euro). Pas saj është komuna Shtip, e cila i ka detyruar 14 stabilimentet që kanë leje të integruara B të paguajnë mesatarisht nga 19,308 denarë (320 euro) në nivel vjetor. Në vendin e pestë është komuna e Kërçovës me të ardhura prej 10,230 denarë apo 170 euro. Ndonëse në territorin e saj ka 7 stabilimente që janë bartës të lejeve të integruara B, komuna e Manastirit ka inkasuar vetëm nga 1,220 denarë apo 20 euro mesatarisht në nivel vjetor. Komuna e Tetovës dhe komuna Çair nuk kanë gjeneruar të ardhura për shkakun se ato nuk i kanë lëshuar lejet e integruara B, por këtë e kanë bërë Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor dhe Qyteti i Shkupit.

#### Të ardhurat mesatare nga lejet e integruara ekologjike B në periudhën 2018-2022

Komuna	Numri i lejeve të lëshuara	Të ardhurat mesatare vjetore në denarë
Strumicë	13	165,017
Kumanovë	11	146,204
Negotinë	4	35,000
Shtip	14	19,308
Kërçovë	2	10,230
Manastir	7	1,220
Tetova	3	0
Çair	1	0

Shikuar në nivel të viteve, në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022, komuna e Manastirit ka planifikuar që për secilin vit të realizojë të ardhura në shumë identike prej 10 mijë denarë. Mirëpo, nuk kanë arritur t'i realizojnë as ato projeksione të ulëta. Pra, komuna e cila ka lëshuar 7 leje në vitin 2018, nuk ka pasur fare të ardhura në këtë bazë. Në vitin 2020 janë mbledhur vetëm 1,890 denarë, në vitin 2021 një shumë modeste prej 1,363 denarë dhe në vitin 2022 një shumë prej 2,847 denarë. Niveli i ulët i projeksionit të këtyre të ardhurave sugjeron në rrezikun se komuna nuk mban evidencë të saktë dhe që subjekteve nuk ua përlllogarit tarifën për leje vjetore të integruar B për periudhën gjatë së cilës janë bartës të lejes.

Komuna e Kërçovës gjithashtu ka pasur të ardhura jashtëzakonisht të ulëta në bazë vjetore. Në vitin 2018, komuna e Kërçovës ka fituar 10,200 denarë në llogarinë e saj, në vitet 2019, 2020 dhe 2021 shuma ka qenë identike edhe atë 7,210 denarë, ndërsa në vitin 2022 shuma ka qenë 19,310 denarë.

Në kërkesën për qasje të lirë, komuna e Shtipit na ka dërguar informacion vetëm për stabilimentet që kanë leje të integruar B dhe për lartësinë e tarifës që ato duhet ta paguajnë për të pasur edhe leje të integruar B edhe për mbikëqyrje të rregullt. Sipas kësaj, komuna nuk ka të dhëna për të ardhurat e realizuara në nivel vjetor, por vetëm për të ardhurat e përgjithshme të realizuara në periudhën 2018-2022. Në të njëjtën kohë, nuk përjashtohet mundësia që edhe këto shuma modeste të të ardhurave të mos jenë arkëtuar në tërësi.

Të ardhurat e realizuara të Komunës së Negotinës në të gjitha bazat për lejet e lëshuara të integruara ekologjike B në periudhën 2018-2022 nuk janë ndryshuar dhe çdo vit shuma e tyre arrin vetëm 35,000 denarë.

Vështruar në nivel vitesh, komuna e Kumanovës në vitin 2021 ka pasur shumën më të lartë të të ardhurave nga lejet e integruara B në vlerë prej 255,392 denarë, ndërsa në vitin 2019 shumën më të ulët të të ardhurave, me vlerë prej 79,241 denarë.

Komuna e Strumicës në vitet 2018 dhe 2019 ka pasur të ardhura në vlerë prej 171,424 denarë në këtë bazë. Në vitin 2020 të ardhurat kanë qenë në vlerë prej 138.164 denarë, pastaj në vitin 2021 në vlerë prej 163,548 dhe në vitin 2022 në vlerë prej 180,527 denarë.

#### Të ardhura nga tarifat për leje të integruar ekologjike B në periudhën 2018-2022

Komuna	Numri i lejeve të lëshuara	2018	2019	2020	2021	2022
Strumicë	13	171,424	171,424	138,164	163,548	180,527
Kumanovë	11	166,480	79,241	98,394	255,392	131,511
Negotinë	4	35,000	35,000	35,000	35,000	35,000
Kërçovë	2	10,210	7,210	7,210	7,210	19,310
Manastir	7	0	/	1,890	1,363	2,847
Shtip	14	nuk i kanë dërguar të dhënat për në nivel vjetor	nuk i kanë dërguar të dhënat për në nivel vjetor	nuk i kanë dërguar të dhënat për në nivel vjetor	nuk i kanë dërguar të dhënat për në nivel vjetor	nuk i kanë dërguar të dhënat për në nivel vjetor
Tetovë	3	0	0	0	0	0
Çair	1	0	0	0	0	0

- Të gjitha të dhënat për të ardhurat e realizuara nga lejet e integruara B janë siguruar përmes Ligjit për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik. Komunat nuk e kanë praktikë për t'i informuar qytetarët për të ardhurat që i realizojnë nga kompanitë që janë bartës të lejeve të integruara B. Mungesa e transparencës e rrit rrezikun për abuzime.

Lartësia e tarifave vjetore të cilën e paguajnë kompanitë që kanë licencë të integruar B dallon prej 915 deri në 22.860 denarë.

Në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, prej komunave të përfshira në këtë hulumtim është kërkuar të dorëzojnë të dhëna për shumën e të ardhura të realizuara në periudhën 2018-2022 në të gjitha bazat që kanë të bëjnë me lejet e integruara ekologjike B për çdo stabiliment veçmas. Megjithatë, vetëm një pjesë e komunave i kanë dërguar ato të dhëna.

Komuna e Strumicës dhe komuna e Kërçovës kanë dorëzuar informacione të hollësishme për të ardhurat e realizuara prej stabilimenteve që kanë leje të integruar ekologjike B veçmas për secilin stabiliment, ndërsa komunat e Manastirit, Negotinës dhe Kumanovës kanë dërguar të dhëna për shumën totale të të ardhurave të realizuara për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022. Komuna Shtip na dërgoi informacion vetëm për shumën e mjeteve të cilën i ka detyruar stabilimentet ta paguajnë, por jo edhe për

të ardhurat që i ka realizuar. Komuna e Çairit dhe komuna e Tetovës nuk realizojnë të ardhura për faktin se ato nuk kanë lëshuar në mënyrë të pavarur asnjë leje të integruar B.

Shumat për tarifën vjetore që i paguajnë kompanitë të cilat kanë leje të integruar B dallojnë nga 915 deri në 22,860 denarë. Nga të dhënat që na janë dërguar, komuna e Manastirit e ka detyruar me vlerën më të ulët stabilimentin IMV-industri e qumështit "Velkovski" edhe atë me 915 denarë. Stabilimentet tjera të cilat nga komuna kanë fituar lejen B, paguajnë tarifë vjetore me vlerë deri 1,890 denarë. Kombinati për prodhimin e betonit Strumicë DG «Beton PM» SHPK Strumica paguan shumën më të lartë, përkatësisht 22,860 denarë për tarifën vjetore për mbajtjen e lejes. Stabilimentet tjera në Strumicë paguajnë shumë e cila lëviz nga 4,690 denarë e deri 19,200 denarë. Me tarifë në vlerë prej 3,721 denar deri në 22,580 denarë janë të detyruara stabilimentet që kanë leje të integruar B t'i paguajnë Komunës së Shtipit, ndërsa në Kërçovë paguajnë nga 7,210 ose 8,100 denarë.

Duke e pasur parasysh që thuajse të gjitha komunat janë përgjigjur se të ardhurat e tyre prej lejeve të integruara ekologjike përdoren për programe apo aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor, është me rëndësi të përmendet që vetëm disa nga komunat e monitoruara kanë program për mjedisin jetësor, edhe atë komunat Strumicë, Kumanovë, Manastir dhe Negotinë.

Vlera e këtyre programeve në buxhetet e përgjithshme lëviz nga përqindja modeste 0.36% në Negotinë dhe deri 2.01% në Komunën e Strumicës. Vështruar nga aspekti i pjesëmarrjes së të ardhurave të realizuara prej lejeve të integruara B në financimin e programeve për mjedis jetësor, rezulton se pjesëmarrja më e vogël është në komunën Manastir me 0.03% ndërsa më e madhja në komunën Strumicë me 7.37%.

#### Vlera e programeve për mjedisin jetësor

Komuna	Buxhetet për vitin 2022	Programi për Mjedisin jetësor në vitin 2022	Pjesa e programit në buxhetin e komunës	Përqindja e financimit të programeve nga të ardhurat prej lejeve të integruara B
Strumicë	1.217.311.189	24.500.000	2.01%	7.37%
Kumanovë	1.859.090.286	29.998.000	1.61%	0.44%
Manastir	1.858.404.537	9.500.000	0.51%	0.03%
Negotinë	373.022.919	1.330.000	0.36%	2.63%
Kërçovë	804.790.174	/	/	/
Tetovë	1.526.335.202	/	/	/
Çair	838.511.179	/	/	/
Shtip	948.401.295	/	/	/

Të dhënat për programet për mjedisin jetësor janë siguruar nga ueb faqet e komunave.



- Duke e pasur parasysh që tarifat vjetore çdo vit janë identike për shumicën e stabilimenteve që posedojnë leje të integruar ekologjike B, kjo mund të interpretohet në mënyrën që disa prej stabilimenteve nuk paraqesin as raporte vjetore për matjet dhe se tarifa e tyre nuk përcaktohet në mënyrë të plotë mbi bazën për leje të lëshuara B. Problem shtesë është se disa prej komunave nuk kanë as inspektorë të licencuar për mjedis jetësor.

Të gjitha komunat thonë se stabilimentet që posedojnë leje të integruara ekologjike B, në bazë të asaj që është përcaktuar në lejet, ato e kanë për detyrë t'i monitorojnë emetimet në mjedisin jetësor dhe të paktën një herë në vit të paraqesin raporte ekspertize nga monitorimi i kryer nga ndonjë subjekt i akredituar. Në rast se inspektori i licencuar për mjedis jetësor ka nevojë për informacione shtesë, ai ka të drejtë të kërkojë matje shtesë të emetimeve.

Disa nga komunat nuk kanë inspektorë të licencuar për mjedis jetësor. Më konkretisht, komuna e Kërçovës dhe komuna e Negotinës nuk kanë inspektorë të licencuar për mjedis jetësor. Në Komunën e Kërçovës ka një inspektor me autorizim, ndërsa në komunën e Negotinës, personi që punon nuk është inspektor i licencuar. Inspektori i licencuar për mjedis jetësor në Komunën e Çairit është punësuar në vitin 2023. Komuna e Tetovës ka pesë inspektorë të licencuar për mjedis jetësor, komuna e Kumanovës dy inspektorë, ndërsa komunat Manastir, Strumicë dhe Shtip kanë nga një inspektor të licencuar për mjedis jetësor.

#### Inspektorët e licencuar për mjedis jetësor

Komuna	Numri i inspektorëve të autorizuar për mjedis jetësor në komunat
Manastir	1
Kërçovë	Nuk ka inspektor të licencuar por 1 inspektor me autorizim
Kumanovë	2
Negotinë	Nuk ka inspektor të licencuar
Strumicë	1
Tetovë	5
Çair	1 (Inspektori është i punësuar në vitin 2023)
Shtip	1

Në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022, komuna e Negotinës dhe komuna e Çairit (detyrim i Qytetit të Shkupit) nuk kanë zbatuar mbikëqyrje inspektuese. Komuna e Kërçovës ka zbatuar vetëm tre mbikëqyrje kontrolluese, ndërsa komunat Manastir, Kumanovë, Tetovë kanë zbatuar inspektime në vazhdimësi gjatë gjithë periudhës. Komunat Strumicë dhe Shtip kanë të dhëna të pjesshme për shkak se inspektorët të cilët kanë punuar në komunë në periudhë të caktuar tanimë nuk punojnë, andaj mungojnë informacionet për inspektimet e kryera në atë periudhë kohore.

Nga Komunën e Tetovës thonë se nuk i kanë të dhënat veçmas për vitet, por përgjithësisht për periudhën pesëvjeçare dhe numri i inspektimeve është 650.

Numri i përgjithshëm i inspektimeve të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese të kryera nëpër komuna

Komuna	2018	2019	2020	2021	2022
Manastir	142	71	20	53	77
Kërçovë	0	0	0	0	3
Kumanovë	172	153	87	183	157
Negofinë	0	0	0	0	0
Strumicë	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	108
Tetovë	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat
Çair	0	0	0	0	0
Shtip	Komuna nuk i ka të dhënat	Komuna nuk i ka të dhënat	7 (Komuna nuk ka pasur inspektor për mjedis jetësor)	18 (Komuna nuk ka pasur inspektor për mjedis jetësor)	4 (Komuna nuk ka pasur inspektor për mjedis jetësor)

Nga komuna Shtip kanë informuar se nuk kanë të dhëna për vitin 2018 dhe vitin 2019 sepse inspektori i mëparshëm nuk punon më në komunë, ndërsa gjatë periudhës 2019-2022 në komunë nuk ka pasur inspektor për mjedis jetësor. Punët urgjente dhe të domosdoshme i ka kryer nga shefi i sektorit për punë inspektuese.

## REKOMANDIME

- » Të mbahet evidencë e përpiktë për lejet e lëshuara të integruara ekologjike B si në nivel komunash ashtu edhe në nivel shtetëror si dhe për qytetarët të sigurohet qasje tek informacionet e këtylla.
- » Vendosje e një sistemi të integruar dhe mekanizmi kontrollues përmes të cilit do të përfshihen tërësisht stabilimentet industriale, përkatësisht objektet të cilat me aktivitetet e tyre emetojnë materie të dëmshme për mjedisin jetësor do të mbulojnë plotësisht dhe si rrjedhojë e kësaj, ato duhet të jenë bartës të lejeve të integruara ekologjike B.
- » Kontrolle joselektive dhe jobjektive më të shpeshta për identifikimin e stabilimenteve të cilat duhet të kenë parashtruar kërkesë për të fituar leje të integruar B, por nuk vepruar në këtë mënyrë, si dhe të subjekteve që kanë leje të këtij lloji për të mbrojtur mjedisin jetësor.
- » Inicim të ndryshimeve në kuadrin ligjor për korrigjim të formulës përmes së cilës përcaktohet shuma e mjeteve të cilën duhet ta paguajnë stabilimentet që kanë leje të integruar B.
- » Komunitat të sigurojnë raporte në nivel vjetor nga operatorët e stabilimenteve lidhur me sasinë e substancave ndotëse dhe këto të dhëna t'i përdorin në përllogaritjen e tarifës vjetore për mbajtje të lejes së integruar ekologjike B.
- » Komunitat t'i përllogarisin tarifën për leje vjetore të integruar B për të gjithë bartësit e lejeve dhe të mbajnë llogarinë për arkëtimin e këtyre kërkesave në përputhshmëri me afatet kohore.
- » Të vendoset një mënyrë e njësuar e përllogaritjes së tarifave për lejet e integruara ekologjike B dhe inicim i ndryshimeve në kuadrin ligjor për të përcaktuar udhëzime më konkrete për përdorimin e mjeteve të inkasuara me dedikim.
- » Plotësimi i të gjitha vendeve të punës të parapara për inspektorë të licencuar për mjedis jetësor në vetëqeverisjet lokale me qëllim që në vazhdimësi të zbatohen mbikëqyrje të rregullta, të jashtëzakonshme dhe kontrolluese mbi kapacitetet industriale.



